



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Politikave Publike dhe Ekonomike përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Sektori Real

Nr.16, Janar - Mars 2014

Vlerësohet se ekonomia vendore përgjatë vitit 2013 u rrit me një shkallë prej rreth 3.2%. Kjo ngritje ishte më e lartë prej rreth 0.8% ne raport me rritjen sa ishte shënuar përgjatë vitit 2012.

4.1% janë parashikimet fillestare për zgjerimin e aktivitetit ekonomik për vitin 2014. Shtytësi kryesor i kësaj rritje pritet të jete rritja e konsumit të përgjithshëm, dhe ne veçanti e konsumit privat, kontributi i së cilit pritet të jetë rreth 3.9%.

Në të njëjtën kohë, investimet e përgjithshme pritet të kontribuojnë me rreth 0.6% në rritjen ekonomike përgjatë vitit 2014.

Gjate vitit 2014 pritet që eksporti i mallrave dhe shërbimeve te jep kontribut ne rritjen e përgjithshme ekonomike prej rreth 1%.

Përderisa, importet e mallrave pritet të ndikojnë negativisht me rreth -1.6% në rritje ekonomike.

Rritja vjetore e BPV -së , në përqindje (%)



Gjatë tremujorit te pare te vitit 2014 çmimet e përgjithshme matur nga Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) vazhduan trendin rënës të filluar nga fillimi i vitit 2013. Në fund të tremujorit të tretë, në mesatare çmimet e përgjithshme shënuan nje rritje prej 0.2%.

Bazuar në raportimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), përgjatë këtij tremujori vërehet ngritje në çmimet e perimeve, bukës dhe drithërave, duhan, veshje, mish etj.

Përderisa kjo ngritje u neutralizua nga rëniet në çmimet e pemëve, naftës dhe benzinit, vajrave dhe yndyrave si dhe sheqer dhe ëmbëlsira.

Bazuar ne zhvillimet ne tregjet nderkombetare dhe vendore, parashikimet per nivelin e inflacionit vendore per vitin 2014 jane ne nivel prej rreth 0.8%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit, IÇK (në %)



Sektori i Jashtëm

Përgjatë tremujorit të pare të vitit 2014, vlera e mallrave të eksportuara dhe mallrave të importuara ishte pothuajse ne nivelin e njejte me periodhen e njejte te vitit te kaluar, ku vërehet nje renie e lehte ne eksportet e mallrave.


Vlera e eksporteve të mallrave gjatë kwtij tremujori ishte rreth €65.7 milionë. Kjo vlerë është më e ulët për rreth 1.6 milion, apo shprehur ne perqindje rreth 2.4% në raport me tremujorin e pare të vitit të kaluar.

Eksporti i mallrave ishte i koncentruar kryesisht ne mallrat te paperpunuara si dhe ne mallrat te perpunuar, te cilat perben mbi 50% te mallrave te eksportuara.

Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtit sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e BE-së mbesin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.

Vlera e importeve te mallrave gjate ketij tremujori ishte pothuajse e njejte me periudhen e njejte te vitit te kaluar. Ne fund te muajit Mars vlera totale e mallrave te importuara shenoj €490.7 milion.

Importi , eksporti dhe bilanci tregtar,në miliona euro



Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga ushqimi i përgatitur, pijet dhe duhani dhe pajisjet makinerike .

Si rezultat i ketyre zhvillimeve bilanci negativ tregtar u thellua për rreth €1 milion gjatë këtij tremujori në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sektori Fiskal

Ecuritë e të hyrave të përgjithshme buxhetore gjatë tremujorit të pare të vitin ishin me pozitive se sa gjate periudhes se njejte te vitit te kaluar.


Të hyrat e përgjithshme në fund të tremujorit të pare të vitit shënuan rreth €310 milionë, shifër e cila është më e larte për rreth 14% në krahasim me tremujorin e pare të vitit 2013.

Te hyrat nga dogana ishin shtytesi kryesor i kesaj ngritje, kjo si rezultat i perfaqësimit signifikant i te hyrave nga doganat ne te hyrat e pergjithshme.

Të hyrat nga Dogana, si burim kryesor i të hyrave të përgjithshme, shënuan €165.5 milionë, shifër e cila është më e lartë për rreth 12% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Tatimet vendore, të arkëtuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, shënuan një ngritje të lehtë për rreth 3.2% në raport me vitin e kaluar duke shënuar vlerë prej rreth €75 milionë te arketuara përgjatë tremujorit të fundit të vitit.


Të hyrat buxhetore,në milion euro



Përderisa shpenzimet e përgjithshme në fund të tremujorit të pare të vitit shënuan rënie prej rreth 4.2% për të arritur vlerën në €268.1 milionë. Kjo renie kryesisht i atribuohet ngadalsimit ne shpenzime kapitale qe e karakterizon fillim vitin.

Shpenzimet kapitale gjatë këtij tremujorit ishin më të ulëta për rreth 54% krahasuar me tremujorin e njëjte të vitit paraprak.

Perderisa, shpenzimet rrjedhëse¹ u ngriten për rreth 19% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, shpenzime të cilat shënuan rreth €215 milionë.



Sektori Financiar

Sektori bankar vazhdoi zgjerimin e tij edhe gjatë këtij tremujori. Asetet totale të sektorit bankar shënuan ngritje prej rreth 8% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Depozitat në sektorin bankar në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan rreth €2.4 miliardë, shifër e cila është më e lartë për 7.1% në raport me tremujorin e parë të vitit 2013. Perderisa u vërejt një rënie prej rreth 0.7% në raport me tremujorin paraprak.


Kreditë arritën vlerën prej €1.8 miliardë në fund të muajit mars të vitit 2014, duke shënuar një ngritje vjetore prej 2.4% dhe 1.1% ngritje në raport me tremujorin paraprak.

Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve, energjetikës, industrisë dhe ndërtimitarisë dhe sektori i bujqësisë.

Norma mesatare e interesit në kredi përgjatë tremujorit të parë të vitit 2014 shënoj 11.20%, që përfaqëson një rënie në normën e interesit në kredi prej rreth 1.4% pikë të përqindjes në raport me periudhën e njëjte me vitin e kaluar.

Ndërsa norma mesatare në depozitat bankare shënoj 1.66%, shifër e cila përfaqëson një rënie prej rreth 1.9% pikë të përqindjes në raport me periudhën e njëjte me vitin e kaluar.

Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



¹ Shpenzimet rrjedhëse përfshijnë: pagat dhe medijet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe subvencionet dhe transferet.

Tabela 1. Agregatet kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2013			2014		
	I			I		
	Janar	Shkurt	Mars	Janar	Shkurt	Mars
<i>§ miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndrysh</i>						
Rritja vjetore e BPV -së						
Sektori Real						
IÇK (në %)	3.6	2.6	2.6	0.2	0.1	0.3
Projeksioni I IÇK-së (në %)						
Sektori i jashtëm						
Importi i Mallrave	139.7	156.4	195.3	130.0	158.3	202.5
Eksporti i Mallrave	21.5	22.7	23.1	20.5	22.1	23.1
Bilanci tregtar	-118.2	-133.7	-172.2	-109.4	-136.2	-179.4
Sektori Fiskal						
Të hyrat e përgjithshme	89.1	73.3	109.5	108.9	97.5	104.1
Të hyrat nga kufiri	44.2	45.9	57.1	45.7	52.7	67.1
Të hyrat vendore	33.5	19.8	19.2	36.6	17.9	20.5
Të hyrat jo tatimore	2.6	2.5	5.6	2.8	2.9	4,158.5
Te hyrat nga dividenta	0.0	0.0	20.0	0.0	0.0	0.0
Mbështetja buxhetore	0.00	0.00	0.00	0.0	0.0	0.0
Kreditë (disbursimet)	0.2	1.6	0.2	11.4	18.6	7.5
Shpenzimet e përgjithshme	38.0	137.1	104.8	63.0	109.8	95.3
Shpenzimet Rrjedhëse	29.5	83.9	67.5	60.6	79.9	74.8
Shpenzimet Kapitale	8.2	52.9	26.8	2.4	26.9	10.5
Remitancat			127.8			
Sektori Financiar						
Depozitat	2,265.1	2,278.3	2,269.4	2,443.4	2,433.4	2,430.8
Kreditë	1,754.9	1,765.6	1,782.7	1,794.5	1,794.3	1,825.9
Asetet Totale te Sektorit Financiar	2,812.6	2,837.8	2,835.7	3,048.5	3,045.0	3,053.1
MHN te korporatave financiare						

Burimi i të dhënave:

Sektorit Real dhe Sektorit i Jashtëm: Enti i Statistikave të Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>

Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MF: <http://mf.rks-gov.net/>

Sektori Financiar: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>